



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RELACION

Mbi

**RAPORTIN E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
PËR VITIN 2023**

Në zbatim të ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, plani i buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar në vlerën 54.757.489.000 lekë, sipas zërave:

- Shpenzime korrente 5.353.440.000 lekë
 - Shpenzime kapitale 49.404.049.000 lekë
- nga të cilat:*
- *shpenzime kapitale me financim të brendshëm* 29.494.294.000 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 19.909.755.000 lekë

Plani i buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, pësoi ndryshime në kuadër të rishikimit të buxhetit:

1. me Aktin Normativ nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023",
 - Shpenzimet korrente, u shtuan në vlerën 4.673.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 11.459.777.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 9.000.000.000 lekë.
2. me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023",
 - Shpenzimet korrente, u pakësuan në vlerën 2.410.460.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 10.542.900.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 1.675.000.000 lekë.

Gjithashtu plani i buxhetit të shpenzimeve korrente në zërin e shpenzimeve të personelit pati ndryshim:

- Nga alokimi i fondit të veçantë, prej 5.426.945 lekë;
- Nga zbatimi i VKM nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione administratës publike” dhe VKM nr.326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe

- punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, prej 68.953.000 lekë;
- Nga zbatimi i VKM nr.834, datë 28.12.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione”, dhe VKM nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të Qeverisjes Qëndrore në procesin e shqyrtimit analitik të *Acquis (SCREENING)* në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, prej 913.000 lekë.

Sqarojmë se:

Në zbatim të VKM nr.111, datë 02.03.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” (i ndryshuar), programi “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”, nuk është në fushën e përgjegjesisë së MIE dhe si i tillë nuk është përfshirë për t’u trajtuar në këtë raport monitorimi.

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për vitin 2023, sipas programeve buxhetore, paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

| Kod Programi | Programi | Plani Fillestar | Plani i rishikuar | Realizimi faktik |
|--------------|---|-------------------|-------------------|-------------------|
| 01110 | Planifikim, Menaxhim, Administrim | 553.900 | 1.650.944 | 1.568.088 |
| 04520 | Transporti Rrugor | 26.237.784 | 42.153.681 | 41.513.612 |
| 04540 | Transporti Detar | 186.380 | 193.254 | 153.315 |
| 04550 | Transporti Hekurudhor | 4.443.376 | 4.634.028 | 4.188.203 |
| 04560 | Transporti Ajror | 2.033.000 | 34.884 | 33.472 |
| 04610 | Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit | 120.000 | 20.000 | - |
| 06370 | Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime | 15.168.551 | 15.979.941 | 15.914.441 |
| 04320 | Mbështetje për Energjinë | 3.613.380 | 2.739.151 | 2.478.239 |
| 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 330.550 | 347.690 | 346.731 |
| 04440 | Mbështetje për Industrinë | 374.585 | 397.435 | 394.993 |
| 06180 | Planifikimi Urban | 177.760 | 96.030 | 90.154 |
| | TOTALI | 53.239.266 | 68.247.038 | 66.681.248 |

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave të shpenzimeve, paraqitet si më poshtë:

në 000 lekë

| Kod Programi | Emertimi Programi | Shpenzime Korrente | Shpenzime Kapitale | |
|--------------|--|--------------------|--------------------------|---------------------|
| | | | me Financim të Brendshëm | me Financim të Huaj |
| 01110 | Planifikim, Menaxhim, Administrim | 1.564.541 | 3.547 | - |
| 04520 | Transporti Rrugor | 3.971.844 | 35.981.192 | 1.560.576 |
| | <i>Projekte infrastrukturore të MIE</i> | | <i>14.05.993</i> | |
| | <i>Projekte të infrastrukturës rrugore/ARRSH</i> | | <i>21.926.198</i> | |
| 04540 | Transporti Detar | 119.762 | 31.971 | 1.582 |
| 04550 | Transporti Hekurudhor | 503.028 | 815.547 | 2.869.628 |
| 04560 | Transporti Ajror | 21.779 | 11.693 | - |
| 06370 | Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime | 401.492 | 13.920.417 | 1.592.532 |
| 04320 | Mbështetje për Energjinë | 140.313 | 343.287 | 1,994,639 |
| 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 234.247 | 112.484 | - |
| 04440 | Mbështetje për Industrinë | 335.452 | 59.541 | - |
| 04610 | Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit | - | - | - |
| 06180 | Planifikimi Urban | 69.291 | 20.863 | - |
| | TOTALI | 7.361.749 | 51.300.542 | 8.018.957 |

Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

PROGRAMI “PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM”

Programi ka si objektiv funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore, krijimin e një stafi permanent dhe sa më të qëndrueshëm, aplikimin e proceseve transparente të konkurimit në përputhje me parimet e barazisë gjinore, motivimin për ngritjen në detyrë sipas rezultateve, me qëllim rritjen e standardeve dhe performancës së punës.

Për vitin 2023 janë realizuar gjithsej 12 angazhime auditimi, nga të cilat 6 auditime financiare dhe 5 auditime të përputhshmërisë dhe një auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Nga auditimet e përputhshmërisë 1 prej tyre është inicuar nga Ministri. Për këtë periudhë, sipas planit vjetor të miratuar kanë qenë planifikuar 12 misione auditimi dhe në fakt janë realizuar 12 misione auditimi. Masa e realizimit është 100%.

Buxheti i vitit 2023 për këtë program buxhetor lidhur me shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale paraqitet:

SHPENZIMET KORRENTE

Gjatë vitit 2023, shpenzimet korrente të programit , pësuan ndryshimet si vijon:

- Akordim fondi nga detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023, në vlerën 993,880 lekë.
- Zbatimi i VKM nr.795 datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qëndrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian" dhe VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.2021 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", shpenzimet për paga (art.600), u shtuan në vlerën 5,800,000 lekë.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", shpenzimeve operative u shtuan në vlerën totale prej 860,000,000 lekë, për kryerjen e pagesave nga vendimet gjyqësore të formës së prerë nga periudhat e kaluara dhe 200,000,000 lekë për shlyerjen e pagesave lidhur me rimbursimin e shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë vendit.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", shpenzimet e personelit (art.600 dhe art.601) u shtuan në vlerën 10,850,000 lekë.

Për këtë program buxhetor, shpenzimet korrente për vitin 2023, janë realizuar si më poshtë:

- *Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore)*, për punonjësit e miratuar në organikë dhe me kontratë, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 341.426.000 lekë është realizuar në vlerën 341.108.355 lekë ose në masën 99.9%.
- *Shpenzime operative*, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 1.002.176.000 lekë është realizuar në vlerën 933.819.820 lekë ose në masën 93.2% duke bërë të mundur shlyerjen e të gjithë detyrimeve gjyqësore të formës së prerë që kishte MIE të mbartura nga vitet e kaluara nga ish Ministrinë.
- *Transferrat korrente të huaja*, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 63.800.000 lekë është realizuar në vlerën 62.218.333 lekë ose në masën 97.5%, pagesa të cilat janë realizuar për 12 organizata ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar aderon sipas fushave të përgjegjësive të MIE, në IMO, UPU, IRENA, ICOLD, ITU, TCT, Energy Community, OTIF, ALVCOLD, CEP dhe DEP (Programi Digital i BE).

- *Transfertat për Buxhetin Familjar dhe Individual*, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 239.941.880 lekë është realizuar në vlerën 227.394.784 lekë ose në masën 94.8% duke berë të mundur shlyerjen e pagesave të 3120 aplikimeve për periudhën 2021-2023 lidhur me rimbursimin e shpenzimeve të transportit për shtetasit shqiptar që vdesin jashtë vendit.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Gjatë vitit 2023, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, pësuan ndryshim në zbatim të Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", u pakësuan në vlerën 9,400,000 lekë për projektet që nuk kishin ecuri të mirë realizimi.

Buxheti i rishikuar për vitin 2023, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është 3.600.000 lekë dhe realizimi financiar është 3.547.000 lekë ose 98%, sipas projekteve:

- "Sistem i mbikqyrjes me kamera nga jashtë godinës nr.2", është planifikuar në vlerën 558.000 lekë dhe është realizuar në masën 100%.
- "Blerje pajisje elektronike pc, printer etj", është planifikuar në vlerën 3.042.000 lekë dhe realizimi financiar është 2.989.000 lekë ose në masën 98%.

PROGRAMI "TRANSPORTI RRUGOR"

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, programi i transportit rrugor synon:

- Të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit;
- Të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Programi synon mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm.

Plani vjetor, në nivel programi për vitin 2023, është në vlerën 42,153,681,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 41,513,612,495 lekë ose 98%, konkretisht:

- Buxheti i shpenzimeve korrente në vlerën 3,995,781,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 3,971,844,000 lekë, ose 99.4%;
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm në vlerën 36,161,768,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 35,981,192,298 lekë ose 99.5%;
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, në vlerën 1,996,132,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 1,560,576,000 lekë ose rreth 78.2%.

SHPENZIMET KORRENTE

Plani vjetor i buxhetit për shpenzimet korrente, të vitit 2023, për programin "Transporti Rrugor", për njësitë shpenzuese, Autoritetin Rrugor Shqiptar, Drejtoritë Rajonale rrugore dhe Institutin e Transportit, paraqitet si vijon:

- Plani vjetor i shpenzimeve të personelit, (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 231,080,000 lekë dhe realizimi financiar vjetor në vlerën 235,040,000 lekë, ose 99%.

Efekti i rritjes së buxhetit për shpenzimet e personelit, gjatë vitit 2023, në vlerën 15,467,000 lekë, erdhi si rezultat i zbatimit nga aktet ligjore:

- VKM-së, nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike".
- VKM nr.795 datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian"
- VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione"".
- Plani i vjetor i shpenzimeve operative në vlerën 3,763,896,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 3,741,663,000 lekë, ose 99%, për financimin e shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve për kontratat e mirëmbajtjes rrugore. Gjatë vitit 2023, ky zë buxhetor, pati një rritje të buxhetit, nga zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023".
- Plani i shpenzimeve për fondin e veçantë 805,000 lekë, është realizuar në vlerën 136,000 lekë, ose 17%.

Me mbylljen e vitit buxhetor 2023, Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka raportuar detyrime të prapambetura, të krijuara rishitazi, për kontratat e mirëmbajtjes rrugore.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, gjatë vitit 2023, pësoi rritje me një vlerë totale prej 17,570,000,000 lekë, nga:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", ku u miratua buxhet shtesë, në vlerën 8,600,000,000 lekë;
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", ku u miratua buxhet shtesë, në vlerën 8,970,000,000 lekë;

Gjatë vitit 2023, ka vijuar financimi i projekteve të kontratave koncesionare, projekte të investimeve të infrastrukturës rrugore, me autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar. Ecuri në realizimin financiar, kanë patur projektet koncesionare/PPP, ku përgjatë vitit, janë kryer pagesat financiare, sipas kësteve të miratuara, në Modelet Financiare të kontratave koncesionare/PPP, si vijon:

- Projekti "Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje, Rruga e Abrit", realizuar 100%.
- Projekti "Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje, Rruga Milot-Morinë", realizuar 100%.
- Projekti "Ndërtim, Operim, Mirembajtje, Rruga Orikum-Dukat-Ura e Shën Elizës", realizuar 100%.

Ka vazhduar zbatimi dhe financimi i projektit të infrastrukturës rrugore "Ndërtim Tuneli i Llogarasë", i realizuar 100%.

Për projektet e infrastruktures rrugore, me financim të brendshëm që zbatohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, gjatë vitit 2023, ka vazhduar zbatimi i projekteve me kontrata të lidhura, sipas grafikut të punimeve. Nga të dhënat financiare "Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve", rezulton se:

Grupi i produktit "Ndërtim Rruge", i shprehur ne sasi ishte parashikuar 70,14 km dhe është realizuar përkatësisht 70,14 km. Shpenzimeve faktike për këtë produkt janë planifikuar në vlerën 18,216,473,000 lekë dhe është realizuar 18,201,231,000 lekë ose 99% e planit.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1' me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), planifikuar për vitin 2023 konkretisht:

| PLANIFIKUAR | FINANCUAR |
|-----------------------------------|-------------------|
| A2 me standartet e reja - 4,62 km | 4.62 km ose 10% |
| A e modifikuar - 7,28 km | 7.28 km ose 100% |
| A2' - 0.33 km | 0.33 km ose 100% |
| B1' - 2.48 km | 2.48 km ose 100% |
| C2 - 55.43 km | 55.43 km ose 100% |

Për zërin "Ndërtim rruge" janë planifikuar fonde buxhetore për kontratat në vazhdim dhe për kontratat e reja, të cilat u miratuan gjatë vitit 2023 dhe zbatimi i tyre filloi në 6 mujorin e dytë të vitit.

Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të reja

Për këtë grup produkti, u planifikuan fonde në vlerën 6,717,796,000 lekë, ose 36.9% ndaj planit total vjetor dhe e shprehur në sasi 4.62 km. Realizimi i shpenzimeve për këtë grup produktesh, në vlerën 6,717,695,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar. Përfshihen në këtë grup projektet rrugore:

- Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 3;
- Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 3;
- Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij;
- Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4, Loti 5, Loti 6, Loti 7;
- Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT;
- Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri-Shkozë, Urat mbi lumin Tirana;
- Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja- Bulevardi i ri, Loti 2;
- Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2, (shtesë punimesh).

Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim.

Për këtë grup produkti, janë planifikuar fonde në vlerën 397,542,000 lekë dhe në sasi 0.33 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grupi produkti është 397,541,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar. Janë realizuar 0.33 km ose 100% e sasisë së planifikuar. Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tipe rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, në disa projekte të rëndësishëm që janë në proces zbatimi si:

- Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit (modifikim kontrate);
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 3;
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 (shtesë punimesh);

Ndërtim rruge tip B1' me dy korsi

Për këtë grup produkti, janë planifikuar fonde në vlerën 2,372,550,000 lekë, ose 13% ndaj planit vjetor dhe në sasi 2.48 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grupi produkti është 2,357,513,000 lekë ose 99.4% e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 2.48 km ose 100% e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tipe rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa projekte të rëndësishme, në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

- "Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4" (shtesë punimesh);
- "Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 8" (sistemimi dhe rivitalizimi i skarpatave);
- "Zgjerimi i rrugës Elbasan-Qafë Thanë (Faza I), (Faza II), (Faza III), (Faza IV);

Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi

Planifikuar fonde në vlerën 7,840,845,000 lekë ose 43% ndaj planit vjetor dhe në sasi 55.43 km. Realizimi i shpenzimeve, për tipin e rrugës C2, është në vlerën 7,840,742,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 55,43 km ose 100% e sasisë së planifikuar. Janë përfshirë kryesisht tipe rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m. Po punohet normalisht në projektet që janë në proces:

- Ndërtim rruga Korçë - Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë dhe e dytë);
- Ndërtim rruga Palasë - Dhërmi (modifikim kontrate);
- Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;
- Rehabilitim i segmentit rrugor Levan - Vlorë (rruga e vjetër).
- Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq - Lozhan i ri Strelcë;
- Ndërtim i rrugës së Fushë-Bardhës, lidhja me rrugën Kardhiq - Delvinë;
- Ndërtimi i rrugës së fshatit Senicë dhe lidhja me rrugën Kardhiq - Delvinë;
- Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore Ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë, Ura e Gajdarit (modifikim kontrate);
- Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) - Autostrada Fier Vlorë;
- Sistemim asfaltim rruga Ura e Cerecenit - Peshkopi Maqellarë, Loti 3;
- Sistemim asfaltim rruga Berat - Ballaban. Loti 3.

Ndërtim rruge A e modifikuar

Ky tip rruge përfaqëson një aks rrugor autostradë me katër vija kalimi 4x3.75 m dhe me dy bankina të asfaltuara me gjerësi 2x3 m, si dhe dy bankina të paasfaltuara me gjerësi 2x1.5 m, së bashku dhe me trafik ndarësen e mesit, gjerësia e trupit të rrugës është 28 m. Për tipin e rrugës A e modifikuar, janë planifikuar fonde në vlerën 887,740,000 lekë ose 4,9% ndaj planit vjetor dhe në sasi 7,28 km. Realizimi i shpenzimeve, për tipin e rrugës A e modifikuar, në vlerën 887,740,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar për këtë zë, i cili është realizuar në sasi 7,28 km ose 100%, në projektet si vijon:

- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3;
- Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano Durrës, Loti 3.

Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore

Planifikuar fonde në vlerën 760,500,000 lekë dhe në sasi 526,19 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 760,092,000 lekë ose 99% e planit dhe në sasi 526.03 km, konkretisht në projektet:

- Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qëndror, Loti 2 (2022);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, në akset e Rajonit Jugor, Loti 3 (viti 2022);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, në akset e Rajonit Verior, Loti 1 (viti 2023);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, në akset e Rajonit Qëndror, Loti 2 (viti 2023);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3 (viti 2023);
- Eleminimi i pikave të zeza (Black spots), në rrjetin rrugor kombëtar 2023;

Ura dhe Emergjencia

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 40,027,000 lekë dhe realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 39,994,000 lekë ose 100%.

"Shpronësime" dhe "Vendime gjyqësore"

| | PLANIFIKUAR | FINANCUAR |
|---------------------|--------------------|-----------------------------|
| • Vendime gjyqësore | 679,354,965 lekë | 626,149,703 lekë ose 92.2 % |
| • Shpronësime | 239,775,000 lekë | 239,775,000 lekë ose 100 % |

TVSH dhe Kosto Lokale

- Kosto Lokale, plani vjetor 777,587,098 lekë, realizimi financiar 777,518,622 lekë ose 100%;
- TVSH, plani vjetor 490,928,328 lekë, realizimi financiar 400,389,231 lekë ose 82%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, gjatë vitit 2023, u pakësua me një vlerë totale prej 2,820,000,000 lekë, nga:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", buxheti u paësua në vlerën 1,845,000,000 lekë;
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", buxheti u pakësua, në vlerën 975,000,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C dhe Kategori të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 1,338 km dhe janë realizuar 1,337 km dhe performanca e produkteve paraqitet:

| | PLANIFIKUAR | FINANCUAR |
|---------------|--------------------|------------------|
| Kategoria B, | 2 km | 1 km ose 50% |
| Kategoria C, | 2 km | 2 km ose 100% |
| Ndërtim Rruge | 1333 km | 1333 km ose 100% |

PROGRAMI “TRANSPORTI HEKURUDHOR”

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet “Reformimi i sektorit hekurudhor për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë”.

Reforma në sektorin hekurudhor që është në proces, përfshin ndarjen e Hekurudhës Shqiptare sh.a në operatorë të pavarur dhe krijimin e autoriteteve të reja hekurudhore sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të miratuara.

Janë krijuar dy autoritete, (1) Autoriteti Licencues Hekurudhor, me VKM nr.657, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e Autoritetit Licencues Hekurudhor” dhe (2) Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore me ligjin 88/2021 “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”, i cili funksionon prej datës 08.09.2023 duke shkrirë Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor Durrës dhe është në proces plotësimi me personel.

Janë në proces të plotësimit me strukturën e miratuar tashmë Autoriteti Rregullator Hekurudhor dhe Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare.

Plani vjetor i buxhetit për vitin 2023, për programin "Transporti Hekurudhor", është në vlerën 4,634,028,000 lekë dhe realizimi financiar vjetor 2023, është në vlerën 4,188,203,000 lekë ose 90%, e realizuar sipas zërave të buxhetit:

- Plani vjetor, për shpenzimet korrente në vlerën 515,150,000 lekë, realizimi financiar vjetor në vlerën 503,027,386 lekë, ose 97.6%.
- Plani vjetor, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, në vlerën 860,529,000 lekë, realizimi financiar vjetor në vlerën 815,547,338 lekë, ose 94.8%.
- Plani vjetor, për shpenzimet kapitale me financim të huaj, në vlerën 3,258,349,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 2,869,627,973 lekë ose 88.1%.

SHPENZIMET KORRENTE

Në këtë program buxhetor janë përfshirë subvencionimi i Hekurudhës Shqiptare sh.a. si dhe shpenzime për funksionimin e administratës së Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Ish-Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, dhe më pas Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore gjatë vitit 2023 ka kryer kontrollet dhe inspektimet si më poshtë:

- Kontroll mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e infrastrukturës hekurudhore, kryesisht linjën Durrës - Tiranë e cila është në rikonstruktim.
- Kontrole në të gjitha stacionet hekurudhore ku shtrihet vija hekurudhore.
- Kontrole në vazhdimësi për trenat e udhëtarit me destinacion Shkodër-Gjormë dhe Golem-Elbasan.
- Kontrole të mjeteve hekurudhore të Hekurudhës Shqiptare dhe të Kompanisë ALBRAIL.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Fondi i pagave për Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore, buxheti për vitin 2023 është 16,727,000 lekë dhe realizimi financiar 10,896,000 lekë, ose 65 %, ku janë paguar ish punonjësit e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor dhe punonjësit aktual të Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore.
- Fondi i sigurimeve shoqërore , buxheti për vitin 2023 është 2,500,000 lekë dhe realizimi financiar 987,518 lekë, ose 40 %.
- Buxheti i shpenzimeve operative për vitin 2023 është 8,300,000 lekë dhe realizimi financiar 2,009,701 lekë, ose 24%.
- Fondi i veçantë, i miratuar në vlerën 123,100 lekë, është realizuar 100%, ku është paguar shpërblimi për pagë, për dalje në pension pleqërie, të punonjësit të ish Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.
- Subvencioni për Hekurudhën Shqiptare sha, buxheti për vitin 2023 është 490,000,000 lekë dhe realizimi financiar 490,000,000 lekë, ose 100%.
-

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Investimet kapitale me financim të brendshëm janë përqëndruar në investimet më kryesore, për mirëmbajtjen e rrjetit hekurudhor në mënyrë që të jetë funksional për qarkullimin hekurudhor. Gjatë vitit 2023 ka pasur ndryshime buxhetore në zërin e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm si vijon:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm u shtuan në vlerën totale prej 400,000,000 lekë.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, u pakësuan në vlerën totale prej 95,000,000 lekë.
- Gjatë vitit 2023, me fondet e SASPAK, u akordua buxhet shtesë, në vlerën 5,529,000 lekë, për financimin e kostos lokale të projekteve me financim të huaj.

Realizimi i investimeve sipas projekteve:

- Projekti "*Pajisje zyre për DP Hekurudhave*", planifikuar për vitin 2023 në vlerën 4,953,636 lekë është financuar 100% e vlerës së parashikuar.

Projekti ka arritur rezultatet e synuara në programin e buxhetit të vitit 2023, duke shënuar ecuri të lartë të indikatorëve të performancës, duke përmirësuar ndjeshëm prezantimin dhe situatën digjitale të H.SH. sh.a.

- Projekti "*Makineri pajisje për mirëmbajtjen e linjës hekurudhore*", planifikuar për vitin 2023 në vlerën 38,136,000 lekë është financuar 38,136,000 lekë, ose në masën 97%.

Janë blerë makineri dhe pajisje të domosdoshme të cilat aktualisht përdoren nga specialistët e linjës hekurudhore për të kryer punime rutinë në procesin e mirëmbajtjes hekurudhore.

- Projekti "*Blerje mjete automobilistike*", planifikuar për vitin 2023 në vlerën 16,000,000 lekë është financuar në shumën 100% e vlerës së parashikuar.

Janë blerë automjete për personelin administrativ të shoqërisë, për të kryer detyrat funksionale.

- Projekti “*Rikonstruksion, modernizim i reparteve/magazinave të H.Sh.sh.a*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 16,000,000 lekë nuk është realizuar për arsye të mungesës dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës.
- Projekti “*Rinovim i trungut hekurudhor Durrës-Elbasan (km00+000–75+000)*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 25,000,000 lekë është financuar në shumën 20,010,240 lekë me tvsh ose në masën 80%.

Projekti shërben për përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore që përfshin kryesisht zëvendësimin e traversave të drurit të vjetra me të reja, zëvendësimi i ballastit të degraduar ose që mungon me ballast të ri, zëvendësimin e aksesorëve që mungojnë në linjën hekurudhore (pllaka lidhëse, pllaka shtruese, gozhdë hekurudhore, bulona të linjës hekurudhore etj.) masa inxhinierike për përmirësimin e trupit të trasesë, të qëndrueshmërisë të elementeve të veprave të artit, ura dhe tombino hekurudhore etj.

Investimi është i domosdoshëm për arritjen graduale të standardeve teknike të infrastrukturës hekurudhore si dhe rritjen e nivelit të sigurisë së lëvizjes së trenave. Përfitimet publike synohen një rrjet hekurudhor me standarde normale teknike, me qëllim që të përballojë nevojat në rritje të lëvizjes së popullatës, sidomos në trungun kryesor dhe të trafikut të mallrave. Në linjën hekurudhore nga Durrësi në Elbasan realizohet lëvizja e trafikut hekurudhor për në Stacionin Elbasan.

- Projekti “*Rinovim i trungut hekurudhor Rrogozhinë – Lushnje (km 35+300–52+350)*” planifikuar për vitin 2023 në vlerën 25,000,000 lekë është financuar në shumën 5,854,752 lekë me tvsh ose në masën 24%.

Projekti shërben për përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore që përfshin kryesisht zëvendësimin e traversave të drurit të vjetra me të reja, zëvendësimi i ballastit të degraduar ose që mungon me ballast të ri, zëvendësimin e aksesorëve që mungojnë në linjën hekurudhore (pllaka lidhëse, pllaka shtruese, gozhdë hekurudhore, bulona të linjës hekurudhore etj.) masa inxhinierike për përmirësimin e trupit të trasesë, të qëndrueshmërisë të elementeve të veprave të artit, ura dhe tombino hekurudhore etj.

- Projekti “*Riparim (rindërtim) vepra arti (ura, tombino)*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 80,000,000 lekë është financuar 100% e vlerës së parashikuar.
- Projekti “*Punime nga vetë hekurudha*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 5,000,000 lekë është financuar 100% e vlerës së parashikuar.
- Projekti “*Hartim i planeve të rievimit të truallit të stacioneve, linjave kryesore dhe degëzimeve hekurudhore*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 15,000,000 lekë është financuar në shumën 14,901,219 lekë me tvsh ose në masën 99.34%.
- Projekti “*Blerje pjesë këmbimi dhe agregate për lokomotiva dhe vagonë*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 11,432,400 lekë është financuar 100% e vlerës së parashikuar.

Për zërin “*TVSH projektsh me financim të huaj*”, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 622,917,981 lekë dhe është financuar në 618,861,013.77 lekë ose në masën 99%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, pësoi ndryshime nga zbatimi i Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", ku fondet e shpenzimeve kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 120,000,000 lekë.

Realizimi i fondeve me financim të huaj, sipas projekteve:

- *Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranës-Rina 1*, planifikuar për vitin 2023 në shumën 1,781,149,000 lekë dhe është realizuar investimi në vlerën 1,352,723,236.4 lekë ose në masën 75%.
- *Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranës-Rinas2*, planifikuar investime për vitin 2023 në vlerën 1,256,500,000 lekë dhe është realizuar financimi në vlerën 1,156,500,000 lekë ose në masën 92%.
- *Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në Aeroportin e Rinasit"*, planifikuar për vitin 2023 në vlerën 75,000,000 lekë dhe është financuar në vlerën 45,000,000 lekë ose në masën 60%.
- *Hartimi i Projektit preliminar Rrogozhinë – Pogradec – Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut)* planifikuar për vitin 2023 në vlerën 81,600,000 lekë dhe është realizuar financimi në vlerën 52,471,440 lekë ose në masën 64.3%.

PROGRAMI "TRANSPORTI DETAR"

Në total, buxheti për vitin 2023, për këtë program është në vlerën 193.254.000 lekë dhe realizimi financiar për vitin 2023, është në vlerën 153.315.328 lekë ose 79%, sipas zërave:

- Për shpenzimet korrente, plani është 124.624.000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 119.762.962 lekë ose 96%.
- Për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, plani është në vlerën 58.630.000 lekë dhe realizimi financiar është 31.970.535 lekë ose 54.5%.
- Për shpenzimet kapitale me financim të huaj, plani është në vlerën 10.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 1.581.831 lekë ose 15.8%.

SHPENZIMET KORRENTE

Në shpenzimet korrente të këtij programi, janë përfshirë shpenzime personeli dhe shpenzime operative për Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës.

Buxheti i vitit 2023, për shpenzimet korrente, pësoi ndryshime buxhetore, nga aktet ligjore të miratuara, si vijon:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", reduktim në vlerën 5,000,000 lekë;
- Zbatimi i VKM-së, nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve,

prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", shtesë për shpenzime personeli në vlerën 11,600,000 lekë.

- VKM nr.795 datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian", VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", rritje të shpenzimeve të personelit, në vlerën 20,000 lekë.

Në këtë program buxhetor, fondet për shpenzimet korrente të vitit 2023, janë realizuar si më poshtë:

- Fondi për shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), është planifikuar në vlerën 107.370.000 lekë dhe realizimi financiar është 106.412.457 lekë, ose 99.1%.
- Fondi për shpenzimet operative, është planifikuar në vlerën 16.956.000 lekë dhe realizimi financiar është 13.055.060 lekë ose 77%.
- Fondi për transfertat buxhetore për familje e individë, është planifikuar në vlerën 298.000 lekë dhe realizimi financiar është 295.000 lekë ose 99%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit vjetor për vitin 2023, janë në vlerën 58.630.000 lekë dhe realizimi financiar është 31.970.535 lekë, ose 54.5%, për projektet:

- Konservim për ndërmarjen e Kontroll Shfrytëzimit të Mjeteve Ujore Vau i Dejës, për likuidimin e pagave, sigurimeve shoqërore të punonjësve, detyrime tatimore dhe ndaj të tretëve.
- "Vazhdimi i sinjalit satelitor LRIT" për vitin 2023 janë planifikuar 3.500.000 lekë, investimi është realizuar në vlerën 3.475.000.
- "Mirëmbajtje pajisje navigacionale" është investim i cili ka filluar në vitin 2020 me vlerë 11.720.000 lekë është realizuar deri tani në vlerën 11.576.000 lekë dhe vlera përfundimtare prej 144.000 lekë e planifikuar për vitin 2023 është realizuar në masën 100%.
- "Blerje Automjete për D.P. Detare" i planifikuar për vitin 2023 në vlerën 4.655.000 lekë, është realizuar në vlerën 4.498.865 lekë ose në masën 96.6%.
- Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë, i planifikuar në vlerën 16.237.276 lekë nuk është realizuar pasi është në proces të marrjes së lejes së ndërtimit.
- "Rikonstruksion i Terminalit të Pasagjerëve Sarandë" është planifikuar në vlerën 8.000.000 lekë është realizuar në vlerën 7.132.000 lekë ose në masën 89.1%.
- "Ndërtimi i hyrjes së Portit Detar Sarandë" është planifikuar në vlerën 15.000.000 lekë dhe realizuar në vlerën 12.529.000 lekë ose në masën 83.5%.
- "TVSH – Bluewbc", është planifikuar në vlerën 30.000 lekë për vitin 2023 dhe është realizuar plotësisht.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit vjetor për vitin 2023, janë në vlerën 10.000.000 lekë dhe realizimi financiar është 1.581.831 lekë, ose 15.8%.

Sipas projekteve realizimi, paraqitet:

- Projekti “MEDEA” është një projekt i cili ka filluar në muajin maj 2018 dhe ka përfunduar në maj 2023. Është grand i financuar nga BE me vlerë totale 8.038.000 lekë. Projekti kishte qëllim forcimin dhe stabilizimin e sigurisë në vendet e rajonit të Mesdheut dhe Detit të zi duke përdorur kërkimin dhe inovacionin si katalizator për të nxitur bashkëpunimin midis praktikuesve nga disiplina dhe vende të ndryshme. Realizimi i projektit për vitin 2023 në vlerën 1.106.058 lekë.
- Projekti “BLUWBC” është projekt i financuar 90% nga BE dhe 10% nga buxheti i shtetit me vlerë 2.466.000 lekë. Projekti ka filluar më 15.01.2020 dhe përfundoi me 14.01.2023. Për vitin 2023 projekti është realizuar në vlerën 321.165 lekë.
- Projekti “Development of master Program MEP&M DPD” është projekt i financuar 100% nga Bashkimi Europian në vlerë 4.001.000 lekë. Projekti ka filluar me 15.01.2021 dhe përfundon me 15 Janar 2024. Në vitin 2023 është realizuar në vlerën 154.608 lekë.
- Projekti “Eureka”, nuk ka patur vijimësi për vitin 2023.

PROGRAMI “TRANSPORTI AJROR”

Ky program merret me hartimin e politikave zhvilluese të transportit ajror që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar gjetjen e burime të ndryshme financuese dhe investuese për infrastrukturën aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues në shërbimet ajrore me qëllim Integrimin e aviacionit civil shqiptar në sistemet evropiane të transportit ajror në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektivat dhe produktet të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara;
- rritjen e standarteve dhe performancës së Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve.

SHPENZIMET KORRENTE

Për këtë program buxhetor, shpenzimet korrente për vitin 2023, janë planifikuar në vlerën 22,184,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 21,778,000 lekë ose në masën 98%.

Sipas klasifikimit ekonomik realizimi rezulton:

- *Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore)*, për punonjësit e miratuar për Autoritetin Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 12,1616,273 lekë është realizuar në vlerën 11,778,180 lekë ose në masën 97%.

- *Shpenzime operative*, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 9,700,000 lekë është realizuar në vlerën 9,643,075 lekë ose në masën 99%.

- *Shpenzime te tjera korrente*, plani i rishikuar i vitit 2023 prej 368,727 lekë është realizuar në vlerën 358,154 lekë ose në masën 97%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Gjatë vitit 2023, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, pësuan ndryshim në zbatim të Aktit Normativ Nr.5, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", u pakësuan në vlerën 2,000,000,000 lekë.

Buxheti i rishikuar për vitin 2023, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është 12,700,000 lekë dhe realizimi financiar është 11,693,000 lekë ose 99.9%, për projektin "Shërbimet inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit".

PROGRAMI "FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME"

Sektori i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është bazuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Furnizimi me ujë i zonave urbane,
- Zgjerimi dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të zonave bregdetare,
- Mbulimin e kostos operative dhe rritjen e performancës së ndërmarrjeve,
- Mbulimin me kanalizime dhe ITUN.

Në nivel programi buxhetor, plani vjetor në vlerën 15,979,941,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 15,914,442,275 lekë ose 99,6% e realizuar, sipas zërave buxhetore, si vijon:

- Buxheti vjetor i shpenzimeve korrente në vlerën 407,694,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 401,492,711 lekë, ose 98,5%.
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm në vlerën 13,938,973,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 13,920,417,389 lekë ose 99.8%.
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, në vlerën 1,633,274,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 1,592,532,175 lekë ose rreth 97,5%.

SHPENZIMET KORRENTE

Fondet buxhetore për shpenzimet korrente, në këtë program, janë realizuar për paga, sigurimet shoqërore e shpenzimet operative për punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve si dhe subvencion për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

Buxheti i vitit 2023, për shpenzimet korrente, pësoi ndryshime buxhetore, nga aktet ligjore të miratuara, si vijon:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", reduktim në vlerën 15,100,000 lekë;
- Zbatimi i VKM-së, nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve,

prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", VKM nr.795 datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian", VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", rritje të shpenzimeve të personelit, në vlerën 11,272,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve korrente, paraqitet si vijon:

- Plani vjetor i shpenzimeve të personelit, (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 72,477,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 72,265,000 lekë, ose 99,8%.
- Plani i vjetor i shpenzimeve operative në vlerën 25,065,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 19,198,000 lekë, ose 76,5%.
- Plani vjetor për subvencionin e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, në vlerën 310,000,000 lekë, është realizuar 100%, sipas kriterëve dhe metodologjisë, të miratuar në zbatim të udhëzimit nr.12, datë 26.09.2023 "Për miratimin e metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve".
- Plani vjetor i akorduar, për fondin e veçantë 152,000 lekë, është realizuar në vlerën 105,000 lekë, ose 69%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, gjatë vitit 2023, pësoi ndryshime buxhetore, me një rritje të planit të buxhetit, në vlerën 6,621,000,000 lekë, nga aktet ligjore të miratuara, si vijon:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", ku u miratua buxhet shtesë, në vlerën 4,906,000,000 lekë;
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", ku u miratua buxhet shtesë, në vlerën 1,715,000,000 lekë.

Realizimi në nivel produktesh, është realizuar si vijon :

1. Produkti A.I, investime në projekte të reja të ujësjellës kanalizimeve. Në këtë kategori produktesh, plani i rishikuar, në vlerën 8,908,554,541 lekë, realizimi financiar në vlerën 8,891,585,299 lekë ose 99%.
2. Produkti A.II. rikonstruksion ujësjellësi. Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar në vlerën 2,763,094,627 lekë, realizimi financiar në vlerën 1,045,238,291 lekë, ose 38%.
3. Produkti A.III: Projekte kanalizimesh te reja. Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar, në vlerën 974,015,719 lekë, realizimi financiar në vlerën 973,686,771 lekë, ose 99%.
4. Produkti A.IV: Rikonstruksion KUZ. Plani i rishikuar në vlerën 193,517,004 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 193,517,003 lekë, ose 100%.
5. Produkti A.V: I.T.U.P, plani buxhetor i rishikuar, për vitin 2023, në vlerën 416,531,063 lekë, realizimi financiar në vlerën 416,495,671 lekë, ose 99%.
6. Produkti A.VI: Konsulencë, plani buxhetor i rishikuar në vlerën 334,490,061 lekë, realizimi financiar në vlerën 310,466,249 lekë, ose 93%.

- Studime, projektim dhe oponencë teknike, planifikuar në vlerën 159,611,260 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 159,611,258 lekë, ose 100%.
- TVSH dhe Kosto Lokale, planifikuar në vlerën 13,779,360,740 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 13,760,806,124 lekë ose 99%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, gjatë vitit 2023, pësoi ndryshime buxhetore, me një reduktim të planit të buxhetit, në vlerën 5,795,000,000 lekë, nga aktet ligjore të miratuara, si vijon:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", buxheti u reduktua me vlerën 5,715,000,000 lekë;
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", buxheti u reduktua me vlerën 80,000,000 lekë.

Realizimi në nivel produktesh, për shpenzimet kapitale me financim të huaj:

- Produkti për rezultatin B.I. Ujësjetësia të rinj, plani i rishikuar në vlerën 1,106,249,590 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 1,087,544,237 lekë ose 98%.
- Produkti për rezultatin B.II. Kanalizimeve të reja, plani i rishikuar në vlerën 737,499,726 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 725,029,491 lekë ose 98%.
- Produkti për rezultatin B.III. Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza, plani i rishikuar në vlerën 106,253,771 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 106,253,771 lekë ose 100%.
- Produkti B.IV: Konsulencë, plani i rishikuar në vlerën 56,054,094 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 46,487,856 lekë ose 83% e planit të akorduar.

Projektet me financim të huaj, të cilat kanë pasur realizim financiar dhe ecuri në disbursimet e fondeve nga donatorët, për vitin 2023, përmendim :

- Programi i Infrastrukturës Bashkiake III dhe IV;
- Infrastruktura Bashkiake V;
- Planifikimi i sektorit të ujit për negociata me BE;
- Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të ujësjetës kanalizimeve;
- Projekti i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm për Bashkinë Durrës;

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR ENERGJINË”

Fondet buxhetore të planifikuara për këtë program, përgjithësisht janë fonde buxhetore në mbështetje të politikave në fushën e efikasitetit të energjisë.

- Plani vjetor për shpenzimet korrente në vlerën 143,040,000 lekë, realizimi financiar vjetor në vlerën 140,312,000 lekë, ose 98% e realizuar.
- Plani vjetor për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, në vlerën 376,111,000 lekë, realizimi financiar vjetor në vlerën 343,286,000 lekë, ose 91% e realizuar.
- Plani vjetor për shpenzimet kapitale me financim të huaj, në vlerën 2,220,000,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 1,056,725,000 lekë ose 47% e realizuar.

SHPENZIMET KORRENTE

Në shpenzimet korrente të këtij programi, janë planifikuar fondeve për shpenzimet e personelit, shpenzime operative për institucionet buxhetore Agjencia Kombëtare e Energjiave Bërthamore dhe

Agjencia e Efiçencës së Energjisë, të cilat kanë si objektiv hartimin dhe implementimin e projekteve në fushën e energjisë, si dhe monitorimin e projekteve në varësi të tyre duke nxitur diversifikimin e burimeve energjitike dhe për të promovuar uljen e konsumit të energjisë nëpërmjet realizimit të masave të efiçencës, si dhe janë planifikuar fonde për pagesat e avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e arbitrazhit ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2023, shpenzimet korrente të programit , pësuan ndryshimet si vijon:

- Akordim fondi nga detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023, në vlerën 600,000 lekë, për Agjencinë Kombëtare Bërthamore.
- Zbatimi i VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", si dhe VKM nr.326, datë 31.05.2023, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", shpenzimet e personelit (600+601), u shtuan me një vlerë totale prej 1,023,000 lekë (ku fondi i pagave u shtua me 810,000 lekë dhe fondi për sigurimet shoqërore u shtua në vlerën prej 213,000 lekë), për Agjencinë Kombëtare Bërthamore.
- Zbatimi i VKM nr.795 datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qëndrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian" dhe VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", shpenzimet korrente (paga), u shtuan në vlerën 537,000 lekë, për njësitë shpenzuese të programit.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve korrente, u shtuan në vlerën totale prej 40,000,000 lekë, për shpenzimet operative të aparatit MIE, për kryerjen e pagesave në proceset gjyqësore të arbitrazhit ndërkombëtar.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve korrente u pakësuan në vlerën totale prej 2,500,000 lekë (pagat në vlerën 1,500,000 lekë dhe shpenzimet operative në vlerën 1,000,000 lekë).

Për këtë program buxhetor, fondet për shpenzimet korrente vjetore për vitin 2023, janë realizuar si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), planifikuar në vlerën 34,090,000 lekë janë realizuar 33,638,000 lekë, ose rreth 98%.
- Shpenzimet operative, planifikuar në vlerën 108,320,000 lekë janë realizuar 106,582,000 lekë ose 98%.
- Transfertat buxhetore për familje e individë, planifikuar në vlerën 630,000 lekë janë realizuar 92,000 lekë ose rreth 14%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Në projektet me financim të brendshëm, janë zbatuar dhe financuar projekte studimore në fushën e auditimit energjetik, rinovimit të ndërtesave me efiçencë energjetike, instalimit të ndricimit me efiçencë të lartë dhe përdorimin e energjive të rinovueshme. Projekte janë implementuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Aparati i MIE. Gjatë vitit 2023, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, ka pësuar ndryshimet buxhetore si vijon:

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve kapitale u shtuan në vlerën 20,000,000 lekë, për financimin e projekteve në fushën e eficientës së energjisë.
- Me fondet e akorduara nga SASPAK, në vlerën prej 106,111,000 lekë, u planifikuan fonde për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, për financimin e zërave të TVSH dhe Kostos Lokale, në projektet me financim të huaj.

Gjatë vitit 2023, janë financuar projektet ekzistuese në proces nga viti 2022, si dhe zbatimi i projekteve të reja, të cilat u lidhen kontratat në 6 mujin e dytë të vitit 2023, si vijon :

- Projekt pilot për instalimin e ndricimit urban me eficientë të lartë energjie, në qytetin e Dibrës;
- Auditim projekt zbatimi dhe realizim punimesh me eficientë energjie në disa shkolla publike në Qarkun e Dibrës;
- Auditim, projekt zbatimi dhe rikonstruksion me eficientë energjitike, në spitalin e Bashkisë Mat;
- Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në qendrën spitalore universitare "Nënë Tereza"
- Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatimi për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pika kufitare;
- Ndërtim i databazës së plotë për konsumet energjitike në gjithë sektoret + suvejimi 3 vjet;
- Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare me eficientë energjie në qytet Berat, Dim, Kuc, Skrap, Polic, Gramsh, Patos, Rosk, Mem, Mallak, Gjirok, Liboh, Përm, Këlcyrë;
- Hartimi i monitorimit të planeve të detajuara sektoriale kombëtare të eficientës së energjive dhe BRE dhe reduktimin e CO2 sipas PKEK (përfshirë metodika monitorimi, verifikimi, raportimi dhe konsulentë për 3 vjet)
- Hartimi i Master planit për ndricim publik në disa qytete sipas tipologjisë së rrugëve.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, ka zbatuar gjatë vitit 2023, projektet në fushën e energjisë, ku janë financuar 100%, nga buxheti i shtetit 8 projekte studimore, si vijon:

- Kontrolli i realizimit të investimeve për ndërtimin e HEC-ve me konçension sipas kontratave përkatëse dhe marrja në dorëzim e tyre, sipas programit të zhvillimit të projekteve të vlerësuar nga Oponenca Teknike - Raporte për Oponencën Teknike.
- Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së - Bilanc Energjetik.
- Studimi për vlerësimin e eficientës së përdorimit të burimeve energjetike hidrokarbure në sektorin e transportit, referuar zhvillimeve teknologjike.
- Rregullore për verifikimin e kritereve të qëndrueshmërisë, normat teknike dhe procedurat për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve.
- Studim mbi ndikimin në mjedis nga aktiviteti në sektorin hidrokarbure.
- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure.
- Monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme.
- Studim mbi rishikimin e kushteve dhe normave teknike, në aktivitetet dhe impiantet e prodhimit, depozitimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Për zërat TVSh-së dhe Kostos Lokale, plani vjetor për vitin 2023, për projektet me financim të huaj, në vlerën 126,324,702 lekë, është realizuar 123,759,070 lekë ose 97%, duke vijuar zbatimin e projekteve me financim të huaj, nga donatorët, si vijon :

- Projektet GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC dhe Re-Source;
- Bashkëpunimi Greqi-Shqipëri për ndërtesat me konsum zero, (Greece Collaborates with Albania for nZEBs);
- Projekti i Bashkive me Energji Inteligjente, SEMP;
- Projekti Pro.Re.Va.TCP, në kuadër të programit INTERREG EURO MED;
- Konvikte të rinovuara me efikasitet të energjisë (Faza e II);
- Programi i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas Parimit të Efikasitetit të Energjisë së Energjisë;
- Projekti Rehabilitimi i Qytetit Studenti Nr. 2;
- Projekti Gate;
- Projekti i Gazsjellësit Fier-Vlorë;
- Projekti REHUB + Efikasiteti Rajonal i Energjisë.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj, për vitin 2023, plani vjetor i buxhetit, pësoi ndryshime buxhetore, në total në vlerën 1,040,000,000 lekë, në zërin e shpenzimeve kapitale me financim të huaj, sipas akteve ligjore, si vijon :

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", u pakesuan fondet ne vlerën totale prej 540,000,000 lekë;
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", u pakësuan fondet në vlerën totale prej 500,000,000 lekë;

Projektet me financim të huaj, të cilat janë zbatuar dhe janë financuar gjatë vitit 2023, përmendim me kryesorët, si vijon:

- Konvikte të rinovuara me efikasitet të energjisë Qyteti Studentit nr.1, programi i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas Parimit të Efikasitetit të Energjisë së Energjisë (Faza I, Faza II);
- Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKTI);
- Projektet GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC dhe Re-Source;
- Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskadën e Drinit;
- Linja unazore 110 Kv e Shqipërisë së Jugut (donator 09/10 KFW);
- Reagimi ndaj Krizës së Pandemisë Covid 19/Ndërtimi i N/Stacionit 110/20 kV, Nëntokësor, Qendër në Tiranë, Komponenti 2.
- Programi i Efikasitetit të Energjisë së Sektorit të Transmetimit - Ndërtimi i linjës 400 kV Shqiperi – Maqedoni (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE”

Fondet buxhetore të programit "Mbështetje për Burimet Natyrore", përgjithësisht janë fonde buxhetore në mbështetje të politikave në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore, me qëllim realizimin e objektivave për:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimin sasior dhe cilësor të rezervave minerare,
- Hartimin e studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimin dhe vlerësimin e pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike, vlerësimin e rrezeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente, mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.
- Shfrytëzimi me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Plani i buxhetit për vitin 2023, është në vlerën 347,690,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 346,731,665 lekë, ose 99.7%.

SHPENZIMET KORRENTE

Gjatë vitit 2023, shpenzimet korrente të programit pësuan ndryshimet si vijon:

- Akordim fondi të veçantë në vlerën 1,395,000 lekë, nga të cilat 695,000 lekë për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar dhe 700,000 lekë për Autoritetin e Sigurisë dhe Emegjencat në Miniera.
- Zbatimi i VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", si dhe VKM nr.326, datë 31.05.2023, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", shpenzimet e personelit (600+601), u shtuan me një vlerë totale prej 5,665,000 lekë për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.
- Zbatimi i VKM nr.795, datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qëndrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian" dhe VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", shpenzimet korrente (paga), u shtuan në vlerën 350,000 lekë, për njësitë shpenzuese të programit.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve korrente u pakësuan në vlerën totale prej 11,770,000 lekë (shpenzimet e personelit në vlerën 6,540,000 lekë dhe shpenzimet operative në vlerën 5,230,000 lekë).

Plani për shpenzimet korrente për vitin 2023, është 235,190,000 lekë dhe realizimi financiar është 234,247,734 lekë ose rreth 99.6%.

Sipas zërave buxhetore, realizimi i shpenzimeve paraqitet si vijon:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 191,610,000 lekë dhe realizimi 191,506,494 lekë, ose rreth 99.9%.

- Shpenzimet operative, në vlerën 41,113,000 lekë, realizuar në vlerën 40,581,275 lekë, ose rreth 98.7%.
- Shpenzime të tjera korrente në vlerën 2,467,000 lekë, realizuar në vlerën 2,159,965 lekë ose rreth 87.5%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Në projektet me financim i brendshëm, janë realizuar investimet për projektet studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit mineral, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike. Projektet e investimeve janë implementuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Sigurisë së Emergjencave në Miniera dhe ndërmarrjet në konservim Albbakër sh.a, Albkrom sh.a, Albinierat sh.a.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2023, janë në vlerën 112,500,000 lekë dhe realizimi financiar është 112,483,931 lekë, ose 99%, në projektet si vijon:

- Projekti, për ndërmarrjet në likuidim "Abminiera", "Albkrom", "Albbakër" sh.a, fondet buxhetore janë realizuar në masën 100%, për likuidimin e pagave, sigurimeve shoqërore të punonjësve, detyrime tatimore dhe ndaj të tretëve.
- Projekti "Raport mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri", është realizuar në masën 100%.
- Projekti "Përditësim gjeohapsinor i të dhënave të lejeve minerare"
- Projekti "Azhornimi gjeohapsinor i hapësirave që krijohen nga shfrytëzimi mineral nëntokësor"
- Projekti "Mbikqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare metalore dhe jometalore"
- Projekti "Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimet teknologjike e mjedisore"
- Projekti "Studim mbi zonimin mineral dhe hartimi i planit vjetor dhe 3-vjecar mineral"
- Projekti "Raport vjetor mbi gjëndjen mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji"
- Projekti "Monitorimi i fenomeneve të postshfrytëzimit në minierat e mbyllura"
- Projekti "Raport mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri"
- Projekti "Blerje pajisje shpëtuese dhe emergjence"
- Projekti "Blerje pajisje zyre"
- Projekti "Blerje pajisje kompjuterike"

PROGRAMI "MBËSHTETJE PËR INDUSTRIJË"

Programi "Mbështetje për Industrinë" ka për qëllim nxitjen e interesit për investime të biznesit vendas dhe të huaj në zhvillimin e veprimtarisë industriale, rritjen e shkallës së përpunimit në vend të burimeve natyrore nëpërmjet proceseve industriale me synim rritjen e kontributit në GDP, eksport, punësim, kryerjen e studimeve tekniko ekonomike në fusha të ndryshme të industrisë, përmirësimin e teknologjive dhe shfrytëzimin e zonave ekzistuese industriale dhe promovimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion, eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtjeje

në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike në varësi të MIE-s, ruajtjen dhe monitorimin e dy landfilleve në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MIE-s (Fier dhe Vlorë) dhe në QGTKRR, konservimin, likuidimin dhe mbylljen e ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s duke realizuar transferimin e plotë të aseteve të mbetura nga administrimi shtetëror në administrim privat.

Për vitin 2023, objektivat e këtij programi buxhetor konsistuan në:

- Rritjen e kontrollit për të garantuar sigurinë e njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion, si dhe nga pajisjet dhe instalimet elektrike, përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- Rritjen dhe përmirësimin e standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme në Qëndrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme.
- Sigurimin e kushteve për administrimin e dy landfilleve në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MIE.
- Nxitjen e interesit për investime të biznesit vendas dhe të huaj në zhvillimin e veprimtarisë industriale.
- Konservimin dhe likuidimin e ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE.

Për realizimin e këtyre objektivave, financohen institucionet si Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme (QGTKRR) Elbasan dhe ndërmarrjet në konservim si Ndërmarrja Azotikut Fier, Ndërmarrja e Prodhim Çelikut Elbasan.

Plani total i buxhetit për vitin 2023, është në vlerën 397,434,490 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 394,992,372 lekë, ose 99.4%.

SHPENZIMET KORRENTE

Gjatë vitit 2023, shpenzimet korrente të programit pësuan ndryshimet si vijon:

- Akordim fondi të veçantë në vlerën 919,890 lekë për Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Zbatimi i VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", si dhe VKM nr.326, datë 31.05.2023, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", shpenzimet e personelit (600+601), u shtuan me një vlerë totale prej 35,000,000 lekë për Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Zbatimi i VKM nr.795, datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qëndrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian" dhe VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", shpenzimet korrente (paga), u shtuan në vlerën 430,000 lekë, për Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial.

- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve korrente u pakësuan në vlerën totale prej 2,300,000 lekë për njësitë shpenzuese të programit.

Plani i rishikuar për shpenzimet korrente, është 337,634,890 lekë dhe realizimi financiar është 335,451,670 lekë, ose rreth 99.4%.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas zërave buxhetore paraqitet si vijon :

- Shpenzimet e personelit, (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 281,215,000 lekë dhe realizimi 280,472,250 lekë, ose 99.7%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 55,500,000 lekë, realizuar në vlerën 54,114,662 lekë, ose 97.5 %.
- Shpenzime të tjera korrente në vlerën 919,890 lekë, realizuar në vlerën 864,758 lekë ose 94%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2023, janë në vlerën 59,800,000 lekë dhe realizimi financiar është 59,540,702 lekë, ose 99.6%, në projektet:

- Projekti “Aparatura Laboratorike për treguesit cilësor të naftës dhe gazit” planifikuar 20,238,000 lekë. Realizuar 100%.
- “Konservim për Azotikun Fier”, fondi i planifikuar 9,000,000 lekë, realizuar 8,886,702 lekë, 98.7%.
- “ Monitorim landfilli” fondi i planifikuar 450,000 lekë, realizuar 304,000 lekë, 68%.
- “Konservim për Nd/jen e Prodhim Çelikut Elbasan” fondi i planifikuar 30,112,000 lekë, realizuar 100%.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR RRJETET E KOMUNIKACIONIT”

Gjatë vitit 2023, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, pësuan ndryshimet buxhetore nga zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u pakësuan në vlerën 100,000,000 lekë.

Referuar shpenzimeve kapitale me financim të huaj me vlerë 20,000,000 lekë, të cilat ishin parashikuar për projektin e WBIF “*Investime në fibër optike në zonat e bardha*”, nuk pati realizim financiar, pasi sipas njoftimit nga WBIF dhe BEI, ky projekt do të konsistojë në asistencë teknike nga WBIF 24 “Zhvillimi Rajonal i Broadband në zonat e bardha për zonat e Jugut & Veriut”, projekt i cili ka filluar më 19.12.2023 duke vijuar në vitin 2024.

PROGRAMI "PLANIFIKIMI URBAN"

Politikat e këtij programi synojnë:

- Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në bashkërendim me çdo sektor;
- Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- Mundëson kushte të përshtatshme për stafin i cili merret me çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Përmirëson kuadrin ligjor në fushën e projektimit.

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit;
- Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi;
- Hartimin e rregullave dhe standarteve të projektimit në fushat e projektimit të universiteteve dhe ambientet ndihmëse të tyre.

Plani total i buxhetit për vitin 2023, është në vlerën 96.030.000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 90.154.164 lekë, ose 94%.

SHPENZIMET KORRENTE

Gjatë vitit 2023, shpenzimet korrente të programit pësuan ndryshimet si vijon:

- Akordim fondi të veçantë në vlerën 280,000 lekë për Arkivin Qëndror Teknik të Ndërtimit dhe Agjensinë Shtetërore të Shpronësimeve.
- Zbatimi i VKM nr.795, datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qëndrore në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian" dhe VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.20210 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2023, të miratuara për disa institucione", shpenzimet korrente (paga), u shtuan në vlerën 130,000 lekë, për për njësitë shpenzuese të programit.
- Zbatimi i Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2023", fondet e shpenzimeve korrente u pakësuan në vlerën totale prej 3,140,000 lekë për njësitë shpenzuese të programit.

Plani i rishikuar për shpenzimet korrente, është 71,030,000 lekë dhe realizimi financiar është 69,291,364 lekë, ose rreth 97.6%.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas zërave buxhetore paraqitet si vijon:

- Shpenzimet e personelit, (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 54,158,000 lekë dhe realizimi 52,753,598 lekë, ose 97.4%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 16,544,000 lekë, realizuar në vlerën 16,319,516 lekë, ose 98.6 %.
- Shpenzime të tjera korrente në vlerën 328,000 lekë, realizuar në vlerën 218,250 lekë ose 66.5%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2023, janë në vlerën 25,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 20,862,800 lekë, ose 83.5%, në projektet:

- Projekti “Pajisje informatike” AQTN, planifikuar 862,800 lekë është realizuar 100%.
- “Shpronësim në zbatim të VKM nr.504, datë 28.08.2021 nga Bashkia Vlorë”, planifikuar 4,137,200 lekë nuk janë realizuar, pasi nuk janë kryer procedurat nga Bashkia Vlorë.
- “Shpronësim në zbatim të VKM nr.125, datë 03.03.2021 nga Bashkia Fier”, planifikuar 18,126,644 lekë është realizuar në 100%.
- Hartimi i planeve të Përgjithshme Vendore është realizuar në vlerën 1,873.856 mijë lekë, është realizuar 100%.

Sqarojmë se:

- Të dhënat faktike lidhur me shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale me financim të brendshëm rakordojnë me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).
- Të dhënat lidhur me shpenzimet kapitale me financim të huaj janë raportuar sipas informacionit të përcjellë nga njësitë zbatuese të projekteve pranë strukturave përgjegjëse të MIE.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Viola Haxhiademi